

INVENTARI I PRODUKTEVE PYJORE JO-DRUSORE (PPJD) NË KOSOVË



**Përgatitur nga
Prof. Dr. Fadil Millaku
Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore
Departamenti i Biologjisë**

Inventarizimi i BMA dhe PFE është financuar nga projekti “Promovimi i Hortikulturës në Kosovë”, i zbatuar nga:



Projekti financohet nga :



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

**MINISTRY OF FOREIGN
AFFAIRS OF DENMARK**



Përmbajtja

1.	<i>Hyrje.....</i>	4
2.	<i>Qëllimi</i>	5
3.	<i>Objektivat dhe synimet e hulumtimit</i>	6
4.	<i>Metoda e punës</i>	6
5.	<i>Rezultatet e studimit.....</i>	8
5.1.	<i>Alpet Shqiptare të Kosovës.....</i>	9
5.2.	<i>Malet e Sharrit.....</i>	12
5.3.	<i>Gollaku</i>	15
5.4.	<i>Kosova Veriore</i>	18
	<i>Regjioni i Mitrovicës</i>	18
	<i>Rajoni i Podujevës</i>	19
5.5.	<i>Kosova Qendrore.....</i>	18
	<i>Rajoni i Skenderajt, pjesës veriore të Klinës dhe pjesës veri-perëndimore të Malishevës</i>	21
	<i>Rajoni i Dushkajës</i>	21
6.	<i>Rezultatet për tërë territorin e Kosovës.....</i>	23
7.	<i>Aktoret e sektorit.....</i>	26
8.	<i>Vlera ekonomike tregu dhe organizimi i grumbullimit dhe shitjes.....</i>	28
9.	<i>Politikat zhvillimore të sektorit</i>	30
10.	<i>Njohja e bimëve kusht për sukses</i>	31
11.	<i>Kullotja/mbikullotja</i>	32
12.	<i>BMA dhe PEF tjera në Kosovë.....</i>	32
13.	<i>Përfundime.....</i>	35
14.	<i>Referencat.....</i>	36
	<i>Shtojca 1 - Emrat e llojeve të MAP dhe pemeve të egra.....</i>	38
	<i>Shtojca 2: Kalendar i vjeljes së BMA dhe PFE</i>	40
	<i>Shtojca 3: Hartat</i>	42
	<i>Shtojca 4: Lokacionet e hulumtuara</i>	46
	<i>Shtojca 5: Personat që ndihmuan në realizimin e projektit.....</i>	51

1. Hyrje

Pozita gjeografike, e kaluara historike e botës bimore, si dhe një varg faktorësh tjerë siç janë: konfiguracioni i relievit, përbërja gjeologjike dhe pedologjike, kushtet klimatike etj, kanë kushtëzuar që Republika e Kosovës të ketë një florë dhe vegjetacion të pasur dhe mjaftë interesant. Këtë e kanë dëshmuar dhe vërtetuar kërkimet e publikimet e deritanishme, si ato në suaza të florës së Ballkanit në tërësi, ashtu edhe ato të karakterit më të ngushtë.

Të dhënat e para për florën dhe vegjetacionin e Kosovës i hasim nga gjysma e parë e shekullit XIX nga Ami Boué. Në hulumtimin e florës dhe vegjetacionit të Alpeve Shqiptare kontribut të madh ka dhënë edhe autor tjerë nga Kosova dhe Evropa.

Vlerat e biodiversitetit ia shtojnë sidomos numri i madh i bimëve endemike dhe stenoendemike të cilat kanë qenë dhe janë resurset me të rëndësishme që duhet ruajtur me fanatizëm. Duhet cekur se këto resurse shpesh kanë qenë dhe ende janë të rrezikuara nga faktori antropogjen. Sidomos të rëndësishme janë edhe grykat e lumenjve e në veçanti zona subalpine dhe alpine të pasura edhe me lloje relikte dhe endemorelikte si dhe me BMA dhe pemë frutore të egra (PFE)

Kushtet klimatike

Kosova ka pozitë mjaft të mirë gjeografike. Është e vendosur pothuajse në qendër të Ballkanit, vijë ajrore 90 km larg detit Adriatik dhe 220 km larg detit Egje.

Në klimën e Kosovës gjatë periudhës së verës ndikon lëvizja e presionit të lartë të ajrit nga zona subtropike në drejtim të veriut, i cili gjendet nën ndikim të aktivitetit të ciklonit nga Oqeani Atlantik dhe deti Mesdhe, si dhe gjatë dimrit nën ndikimin e anticiklonit siberian.

Në Kosovë është e mundur të veçojmë dy rajone themelore klimatike: malore dhe të ultësirave.

Temperatura mesatare e ajrit gjatë vitit në zonën e ulët dhe kodrinore është 10.72 °C. Periudha më e ftohtë gjatë vitit zgjatë katër muaj (Dhjetor, Janar, Shkurt dhe Mars). Temperatura mesatare më e ulët e ajrit është në muajin janar (- 0.9 °C), ndërsa ajo më e lartë është në muajin gusht (21.15 °C).

Në kuadër të rajonit malor hyjnë zonat mbi 1500 m.l.m.d. Zona sub-alpine dhe alpine që janë shumë të pasura me BMA dhe pemë frutor, hyjnë në kuadër të klimës malore, me elemente të klimës sub-alpine dhe alpine të vërtetë. Në këto hapësira dominojnë kushtet klimatike ekstreme. Temperatura mesatare vjetore është rreth 10°C. Temperatura mesatare për muajin janar është -8°C, ndërsa gjatë verës ajo arrin rreth 10°C. Vera është e shkurtër dhe e freskët. Vjeshta është më e ngrohtë se pranvera. Në prill temperatura mesatare është nën 0°C, ndërsa në tetor është mbi 0°C.

Mesatarja vjetore e reshjeve atmosferike është mbi 1500 mm. Reshjet më të mëdha janë gjatë muajve të ftohtë të vitit (rreth 1000 mm), ndërsa gjatë periudhës vegjetative janë më të pakta (rreth 500 mm). Dimri është i ftohtë dhe i gjatë.

Vegjetacioni

Fitocenoza që paraqesin vlera shkencore dhe resurse natyrore për BMA dhe pemë frutor

Sa i përket vegjetacionit rëndësi të veçantë paraqesin fitocenozat endemorelikte shumica e të cilave janë prezent në Alpet Shqiptare (Kosovë) dhe në Malet e Sharrit pa lërë anash

edhe Koritnikun e sidomos Pashtrikun të cilin mund ta quajmë edhe si park natyror i vetëmbrojtur.

Në lugina të lumenjve dominojnë lloje të shëlgut (*Salix* sp.) dhe plepit (*Populus* sp.) duke formuar fitocenoza të caktuara nga rendi *Populetalia*.

Zona kodrinore e Kosovës është e mbuluar kryesisht nga pyjet e dushkut ku dominojnë llojet si *Quercus frainetto* (shpardihi), *Quercus cerris* (qarri), *Quercus pubescent*, *Quercus petraea* (bung buta), dhe *Castanea sativa* (gështenja) e përhapur në Malet perëndimore të Kosovës që i takojnë Rendit *Quercetalia pubescentis*.

Në zonën e Pashtrikut dhe Koritnikut është prezent dhe në shumë lokalitete dominon qarrazi (*Quercus trojanae*) që ka rëndësi edhe shkencore dhe formon fitocenzën karakteristike *Quercetum trojanae* dukagjini.

Në rajone ku dominojnë shkëmbit serpentin është mjaft e përhapur dëllinja e kuqe (*Juniperus oxycedrus*) si dhe voshtra (*Forsytia europae*) si bimë endemike e Kosovës dhe Shqipërisë.

Mbi zonën e dushkut në Kosovë shtrihet pylli i ahut (*Fagus moesiaca*) i cili formon fitocenoza të ndryshme në kuadër të rendit *Fagetalia sylvestris*:

Në Alpet Shqiptare, në Koritnik dhe në Malet e Sharrit janë të përhapura edhe llojet mjaft interesante dhe endemike si arneni (*Pinus peuce*) dhe rrobulli (*Pinus cheldreichi*) duke formuar kështu pyje të cilat kanë karakter shkencor dhe si të tilla duhet të mbrohen dhe mirë menaxhohen.

Zonën me të lartë të pyllit e formon dredhaku (*Pinus mugo*) i cili sidomos në Alpet Shqiptare arrin të formoi pyje deri në 2000 m. Edhe pse nuk ka dru kualitativ është shumë i rëndësishëm si bimë mjekësore dhe industriale dhe për natyrën sepse e mbron me së miri tokën nga erozioni kur dihet fakti se erozioni fillon nga lartë e vazhdon deri të zona e ulët.

Në zonën subalpine dhe alpine dominojnë bimët e tipit të shkurreve si dëllinja (*Juniperus nana*), boronica (*Vaccinium myrtillus*, *V. uliginosum*) dhe bimët barishtore shumëvjeçare në kuadër të të cilave edhe shumë BMA.

Në kuadër të vegjetacionit të kullosave subalpine dhe alpine të Alpeve Shqiptare vend me rëndësi zënë vegjetacioni barishtor nga *Ass. Carici Crepidetum dinaricae* dhe *Ass. Festucetum albanicae*.

Në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit është i zhvilluar mirë edhe vegjetacioni i tëbanave (torishtave) i përfaqësuar me *Ass. Senecio-Rumicetum alpini*, i cili shtrihet zakonisht në zonën subalpine.

2. Qëllimi

Qëllimi i këtij hulumtimi është përgatitja e një inventari të BMA dhe PEF për tërë Kosovën që do të shërbente për marrje të informacionit për llojet e ndryshme të BMA të përhapura në Kosovë. Përgatitja e këtij inventari është kryer me mbështetjen e projekteve "Promovimi i Hortikulturës në Kosovë", zbatuar nga "Intercooperation" dhe financuar nga Qeveritë Zvicerane dhe Daneze dhe pjesërisht edhe nga Projekti i CARE Kosova, financuar nga qeveria Hollandeze, si pjesë e aktiviteteve për zhvillimin e sektorit të Bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA) dhe PFE.

Ky inventarizim do t'u shërbej institucioneve të Kosovës dhe akterëve të sektorit për të prezantuar potencialin ekonomik të BMA dhe do të jete një bazë e mirë që do të shërbejë

për certifikimet në bazë të standardeve ndërkombëtare të cilësisë, p.sh. certifikimi organik.

3. Objektivat dhe synimet e hulumtimit

Objektivi kryesor:

- Inventarizimi BMA (bimet mjekesore dhe aromatike) dhe PFE (pemet frutore të egra) që rriten në mënyrë spontane në territorin e Kosovës
- Krijimi i një harte me informata lidhur me BMA
- Të arrihet një koleksion organik natyror
- Adaptimi dhe zbatimi i rregullave të përgjithshme lidhur me grumbullimin e BMA

Objektivat e përgjithshme:

- Edukimi i grumbulluesve të BMA lidhur me metodologjitë e reja të grumbullimit.
- Krijimi i hallkave të nevojshme midis kompanive të licencuara dhe grumbulluesve të vegjël të BMA dhe PFE (pemet frutore të egra) si element i rëndësishëm për funksionimin e këtij sistemi më rëndësi ekonomike dhe sociale.
- Informimi i popullatës në vendet rurale për kapacitetet me BMA dhe PFE dhe rëndësia e tyre në zhvillimin e ekonomive shtëpiake.
- Të rekomandoj ndryshime të përshtatshme në aspektin e hartimit të një strategjie shtetërore për zhvillimin e mëtutjeshëm dhe të qëndrueshëm të këtij sektori me rëndësi kombëtare.

4. Metoda e punës

Janë organizuar ekskursione ditore dhe javore në të gjitha rajonet e pasura me BMA dhe PFE në mbar territorin e Kosovës. Gjatë vitit 2007 janë hulumtuar Alpet Shqiptare të Kosovës (Bjeshkët e Nemuna), gjatë vitit 2008 Malet e Sharrit dhe zona e Gollakut, Vitisë dhe Gjilanit, kurse gjatë vitit 2009 pjesa Veriore dhe Qendrore e Kosovës.

Janë vizituar rajone të pasura BMA dhe PFE

Në çdo parcelë të pasur me BMA dhe PFE janë kryer veprimet si me poshtë:

- Është bërë inventarizimi i BMA dhe PFE dhe në mënyrë vizuale është caktuar sipërfaqja në hektar për secilin lloj. Janë paraqitur me numra nga 5-1 prezenca dhe sasia e BMA dhe PFE.
- Me peshore janë bërë matjet sasiore të llojeve të BMA barishtore dhe gjysmëshkurre prej 1 m² sipërfaqe - 100 m². Është gjetur mesatarja për 1 hektar dhe është shumëzuar me numrin e hektarëve.
- Për BMA drunore ose shkurre është konstatuar së pari numri i individëve për 1 hektar dhe është nxjerrë mesatarja e kg për individ e pastaj është llogaritur sasia kg/ha.
- Janë bërë matjet me GPS: - koordinatat dhe lartësia mbi detare.

Llogaritja e sasisë në Kg

a) Për BMA që janë barishtore dhe mbledhet pjesa mbi tokësore ose siç quhet në shkencë herba, është llogaritur sasia në kg si në shembullin e mëposhtëm:

Origanum vulgare - herba

Në 10 vende/ha sipas metodes së rastit, është korrur me drapër nga 1 m² (herba), pastaj është matur sasia e njomë për 1 m². Kjo sasi është tharë dhe është peshuar - nga 0.860 kg masë e njomë ka mbet 0.215 kg masë e thatë. Janë bërë 10 matje dhe është nxjerrë një mesatare. Psh. lloji *Origanum vulgare* pas matjeve ka dal se vetëm 15% të sipërfaqes së matur janë të pasura me këtë lloj. d.m.th. nga 10 000 m² sa ka një hektar janë llogaritur vetëm 1500 m². Së pari shumëzohet numrin e m² me sasinë e BMA për 1 m². Pastaj gjejmë mesataren për 1 hektar dhe këtë numër të fituar e shumëzohet me numrin e hektarëve. Kështu fitohet masën në kg për zonën e caktuar .p.sh.

Tab. 1. Shembuj si është llogaritur sasia e rignonit (*Origanum vulgare*)

Sipërfaqja me Origano (m ² /ha)		Masa e thatë (Kg/m ²)		Totali (kg/ha)		Sipërfaqja ne malet e Sharrit (ha)	Totali me Origano (kg)
1,500	X	0.215	=	322.5	X	280	90,300

b) Për të llogaritur sasinë e pemëve frutor, së pari është matur pesha e freskët e produktit nga një individ (qoftë lule, gjethe, fruta ose lëvore). Pastaj është llogaritur sa masë e thatë mund të përfitohet pas tharjes. Në mënyrë vizuale është caktuar numri i individëve për një hektar dhe është nxjerr mesatarja.

Shembull: Molla e egër – fryti (*Malus sylvestris*: - fructus)

Janë vjelë disa trupa të mollës së egër dhe është nxjerrë mesatarja për një trup masë të freskët. Pas grirjes në flegra dhe tharjes së frutave është llogaritur mesatarja për një trung që ka qenë 25 kg masë e thatë. Janë numëruar në disa vende numri i trupave në sipërfaqe prej 1 ha. Është nxjerrë mesatarja e cila në vendet ku molla e egër është shënuar me 5 janë numëruar rreth 40 trupa. Kështu është llogaritur sasia e mundshme në kg për hektar. Psh.

25 kg/trung X 40 (individ/ha) = 1000 kg/ha; d.m.th në vende ku molla e egër është e përhapur (5) mund të vjelën rreth 1000 kg/ha. Në kuadër të Maleve të Sharrit sipas matjeve provizore të bëra janë rreth 140 ha. Në qoftë se shumëzohet hektarët (140) me kg për hektar atëherë del se në Malet e Sharrit mund të grumbullohen deri 140 000 kg. ose llogaritur 140 (ha) X 1000 kg/ha = 140.000 kg.

Tab. 2. Shembull, si është llogaritur sasia e frutit të mollës egër (*Malus sylvestris*)

Numri i trupave Copë/ha		Pesha e mollëve për trup (Kg)		Totali (kg/ha)		Sipërfaqja ne malet e Sharrit (ha)	Totali me molle ne Malet e Sharit (kg)
40	X	25	=	1,000	X	140	140,000

c) Për të llogaritur sasinë në kg të BMA barishtore kur vjelët lulja ose lulesa, p.sh. Agulicë (*Primula veris*), janë vjelë në disa vende 1 ha me lule të agulicës. Janë matur si masë e njomë dhe pastaj janë tharë dhe peshuar përsëri. Kështu është nxjerrë një mesatare e shprehur në kg për ha. Kjo shifër (mesatare) ka qenë 5 kg masë e thatë për ha në vendet ku agulicja është shënuar me numrin 5. Për të llogaritur sasinë në kg kemi vepruar në këtë

mënyrë: janë shumëzuar nr. i hektarëve (1840) me kg/ha (5 kg) dhe është gjetur sasia në kg.

Tab. 3. Shembull, si është llogaritur sasia e luleve të aguliçes (*Primula veris*)

Sipërfaqja me Aguliçe (ha)		Masa e thatë (Kg/ m ²)		Totali (kg/ha)		Sipërfaqja ne Malet e Sharrit (ha)	Totali me Aguliçe ne Malet e Sharrit (kg)
1840	X	0.0005	=	5	X	1,840	9,200

Llogaritja e sipërfaqes provizore (Ha)

Sipërfaqet në hektar me BMA dhe PFE janë caktuar në mënyrë vizuale. Në lokalitete ku janë bërë matjet Abudanca (nr. i individëve në hektar) si dhe Dominanca (mbulesa që zënë individët e të njëjtës specie) është paraqitur me numra nga 5 deri 1 (Metodë e përdorur ne fitocenologji sipas botanistit Brown-Blaquet-por e modifikuar për të llogaritur sipërfaqen në hektar për specie), ku:

Numri 5 paraqet përafërsisht 100 hektar me BMA;

Numri 4 paraqet përafërsisht 80 hektar me BMA;

Numri 3 paraqet përafërsisht 60 hektar me BMA;

Numri 2 dhe 1 paraqesin prezencën e një lloji që në ato sipërfaqe është me pakicë.

Për të caktuar numrin e hektarëve me BMA dhe PFE është shumëzuar shuma e numrave (5 deri 1) me koeficientin/faktorin 20 (5 x 20 = 100 ha), si p.sh.

Tab. 4. Shembull, si është llogaritur sasia e dëllinjës (*Juniperus communis*)

Emri shkencor	Shuma e matjeve	koeficientin/faktorin	Totali (ha)
<i>Juniperus communis</i>	83	20	1,660

Vërejtje: për llojet: boronica (*Vaccinium myrtillus*), dëllinja (*Juniperus communis*), Petaesites hybridus dhe P. albus është llogaritur masa e njomë për hektar.

5. Rezultatet e studimit

Informacionet lidhur me BMA dhe PFE të Republikës së Kosovës janë origjinale dhe të fituara gjatë tri vjetëve studime (2007, 2008, 2009). Gjatë vitit 2007 është hulumtuar pjesa perëndimore e Kosovës (Alpet Shqiptare të Kosovës) duke filluar nga Mali Mokna deri të Rrasa e Zogut si dhe rajoni i Gollakut, Kamenicës, Gjilanit dhe Vitisë. Gjatë këtij viti kam kontaktuar me kompanitë dhe të gjithë akteret e involvuar në këtë proces duke krijuar lidhje dhe duke ju dhënë informacione të rëndësishme rreth BMA dhe PFE. Gjatë vitit 2008 është hulumtuar pjesa jugore dhe lindore e Kosovës (Malet e Sharrit) duke




Fig. 1. Zonat e hulumtuara

filluar nga Prizreni deri të Gryka e Kaçanikut. Edhe gjatë këtij viti kam ndihmuar me sugjerime kompanitë dhe grumbulluesit e BMA duke krijuar lidhje dhe shkëmbim të informatave në kuadër të krejt sistemit.

Gjatë vitit 2009 është hulumtuar pjesa veriore dhe qendrore e Kosovës duke përfshi edhe një pjesë të Dukagjinit. Pjesa veriore (rrethi i Mitrovicës dhe Podujevës) ka një bazë me të mirë dhe infrastrukturë për grumbullimin e BMA dhe PFE në krahasim me pjesë Qendrore e cila paraqet një potencial mjaft të mirë sidomos kur janë në pyetje PFE.

Informacione shtesë janë marrë nga Kompanitë grumbulluese, Komunitat, Departamenti i pylltarisë dhe mbledhësit e vegjël.


5.1. Alpet Shqiptare të Kosovës

Pozita gjeografike

Alpet Shqiptare gjenden në pjesën perëndimore të Kosovës dhe shumë autorë ato i quajnë si Malet Perëndimore të Kosovës. Ato sipas disa autorëve janë vazhdim i Maleve Dinarike.

Duke marrë parasysh grykën e Deçanit, Pejës dhe Zhlebin Alpet Shqiptare brenda kufijve të Kosovës mund të grupëzohen në katër grupe grupe.

- Në grupin e parë (Bjeshkët e komunës së Istogut) hyjnë terrene nga Mali Mokna deri të gryka e Zhlebit.
- Në grupin e dytë (Ana veriore e Rugovës) hyjnë malet që shtrihen në veri dhe verilindje të Grykës së Rugovës dhe përfshijnë terrene nga Gryka e Rugovës deri të Gryka e Zhlebit.
- Grupi i tretë (Alpet qendrore) është i përbërë nga malet të cilat gjenden në mes të Grykës së Rugovës dhe Grykës së Deçanit.
- Grupi i katërt (Gjeravica me rrethinë) shtrihet në jug dhe perëndim të Grykës së Deçanit në drejtim të perëndimit dhe jugperëndimit deri të kufiri Shqiptar dhe Malazez.



Përbërja gjeologjike

Përbërja gjeologjike e Alpeve Shqiptare është mjaft e komplikuar dhe kjo më së miri shihet në grykat e Lumbardhit të Pejës, Deçanit, Grykës së Lloçanit dhe lumit Erenik. Përveç shkëmbinjve gëlqeror që përbëjnë pjesën më të madhe të Alpeve Shqiptare, janë të pranishëm edhe shkëmbinj silikate të cilët paraqiten në pjesën më të madhe të masivit të Gjeravicës dhe serpentiner që paraqiten në mënyrë fragmentare në Gjeravicë, Rops, Dervish Kom, Kurvallë dhe Koprivnik.


Përbërja pedologjike

Mbulesa pedologjike e Alpeve Shqiptare është mjaft heterogjene dhe përbëhet nga disa tipe të tokave.

Mbulesa pedologjike e Alpeve Shqiptare mund të klasifikohen në disa tipe të tokave. Prej tyre më të rëndësishmet janë:

- Ranker tipik në shkëmbinj neutral,

- Ranker tipik në shkëmbinj acidik (pH 4-5),
- Tokë litosoli ose regosoli në karbonat,
- Tokë acidike hidrogjene,
- Tokë e kuqe e kafenjzuar mbi formacione gëlqerore të fortë,
- Tokë rendzinë mbi shkëmbinj dolomit ose gëlqerorë,



BMA dhe PFE me potencial ekonomik në Alpet Shqiptare të Kosovës


Alpet Shqiptare të Kosovës përshijnë një territor mjaft të gjerë dhe të pasur me BMA dhe PFE. Këtë e kanë mundësuar një varg faktorësh e ndër ta edhe shtrirja e tyre dhe lartësia e madhe mbi detare (deri 2656 m). Hulumtimi i këtij rajoni në aspektin e vlerave ekonomike dhe potencialet me BMA është bërë gjatë vitit 2007.

Në bazë të këtyre hulumtimeve kemi arritur që të inventarizojmë BMA dhe PFE që kanë potencial ekonomin. Këto bimë janë evidentuar dhe paraqitur në tabelë (Tab. 5)

Tab.5: Sasia e BMA dhe pemë të egra në Alpet Shqiptare të Kosovës

	Bjeshka e Istogut	Ana veriore e Rugovës	Alpet qendrore	Gjeravica	Totali
Emri shkencor	Kg				
Achillea millefolium (H)	65,300	26,650	20,150	9,100	121,200
Aconitum napelus ®	19,800	25,300	9,900	14,300	69,300
Anemone nemorosa (H)	29,500	34,220	22,420		86,140
Antennaria dioica (H)	1,800		2,400		4,200
Arctostaphylos uva-ursi (Fol)		23,300			23,300
Asperula odorata (H)	7,800	3,600	2,400		13,800
Atropa belladonna (Fol)	1,080	900	99	900	2,979
Bellis perennis (Fl)	14,000	1,480	16,280	5,920	37,680
Betula pendula (Fol)		68,000	16,000	16,000	100,000
Carlina acaulis ®	28,000	4,800	14,000	1,200	48,000
Centaurium erythraea (H)	18,000	12,000	27,000		57,000
Cetraria islandica (H)	20,700		27,000		47,700
Cichorium intibus ®		12,800	9,600		22,400
Convallaria majalis (H)	28,800	9,600	60,000		98,400
Cornus mas (Fr)	45,600	98,800	144,000		288,400
Corylus avellana (Fr)	14,000	15,000	14,000		43,000
Crataegus monogyna (Fl-Fol)	95,000	90,000	20,000		205,000
Crocus sp.(ST)	240	48			288
Digitalis lanata (Fol)	16,100	6,000	16,800		38,900
Epilobium angustifolium (Fol)		14,700	21,000	3,500	39,200
Fragaria vesca (Fol)	26,000	7,812	9,140	1,736	44,688
Frangula alnus ®	1,800		1,050		2,850
Fraxinus ornus (Fl)	84,000	25,200	25,200		134,400
Galium verum (H)		67,320	29,900		97,220

	Bjeshka e Istogut	Ana veriore e Rugovës	Alpet qendrore	Gjeravica	Totali
Emri shkencor	Kg				
Gentiana asclepiadea ®	2,012	4,022	4,600	1,040	11,674
Gentiana punctata ®	19,600	5,600		25,200	50,400
Geranium macrorrhizum®	326,400		76,800		403,200
Hedera helix (Fol)	50,400	14,400	21,600		86,400
Hypericum alpigenum (H)		28,800	27,200	16,300	72,300
Hypericum perforatum (H)	129,600	90,720	87,800	7,200	315,320
Juniperus communis (Fr)	195,000	20,000	60,000		275,000
Juniperus nana (Fr)	36,000	6,000	32,000	36,000	110,000
Juniperus oxycedrus (F)			14,400		14,400
Malus sylvestris (F)	80,000	60,000			140,000
Mentha longifolia(Fol)	11,200	16,800	39,000		67,000
Ononis spinosa					-
Orchis morio (B)	4,200	1,540			5,740
Origanum vulgare (H)	25,700	45,000	19,320		90,020
Petasites albus ®		50,000	100,000	50,000	200,000
Petasites hybridus ®	72,000	126,000	342,000	90,000	630,000
Primula acaulis (Fl)	8,400	6,300	3,000		17,700
Primula veris (FL)	11,040	3,840	4,080	1,440	20,400
Prunus spinosa (Fr)	28,000	21,000	28,000		77,000
Pteridium aquilinum ®	308,000	154,000	616,000		1,078,000
Pyrus sp.	40,000				40,000
Robinia pseudoacacia(Fl)	21,000	63,000	37,800	2,000	123,800
Rosa sp. (Fr)	288,000	144,000	40,000		472,000
Rubus fruticosus (Fr)	7,200	24,000	14,400		45,600
Rubus idaeus (Fr)	23,200	4,400	7,200		34,800
Salix alba	20,000	30,000	20,000		70,000
Sambucus nigra (Fl)	12,480	2,880	7,680		23,040
Tanacetum vulgare		7,200	14,400		21,600
Taraxacum officinale (Fol)	30,800	50,000	7,000	3,960	91,760
Teucrium chamaedrys (H)	22,400	21,120	23,760		67,280
Thymus sp. (H)	80,900	40,480	82,800	33,112	237,292
Tilia cordata (Fl)	45,000	12,000	18,000		75,000
Tussilago farfara (Fol.)	37,800	38,850	38,800	5,250	120,700
Urtica dioica ®	172,800		18,000	18,000	208,800
Vaccinium myrtillus (Fr)	27,000	99,000	84,000	93,000	303,000
Veratrum album.(R)	62,400	25,600	11,200	33,600	132,800
Verbascum thapsus (Fl)	7,650	4,950	2,700	1,350	16,650
Veronica officinalis (H)		6,900	18,400	9,200	34,500
Viola odorata (Fl)	890		120		1,010
Viola tricolor (Fl)	2,800		168	168	3,136
Totali					7,413,367



Nga tabela 5 shihet së ky regjion është i pasur me BMA dhe PFE. Prej BMA që kanë rëndësi ekonomike dhe që janë të kërkuara në tregun botëror janë: boronica (*Vaccinium myrtillus*), dëllinja (*Juniperus communis*), aguliçja (*Primula veris*), shtogu (*Sambucus nigra*), molla e egër (*Mallus sylvestris*), murrizi (*Crataegus monagina*), thana (*Cornus mas*), lule basami (*Hypericum perforatum*), gështenja (*Castanea sativa*), barpezmi (*Achillea millefolium*), hithra (*Urtica dioica*), listra (*Thymus sp.*), trëndafili i egër (*Rosa canina*) etj.

5.2. Malet e Sharrit

Në kuadër të Maleve të Sharrit, Kosovës i takojnë pjesët veriore që përfshijnë hapësirën prej rreth 1100km² ose rreth 1/10 e hapësirës së Kosovës. Vija që përkufizon kuotat e larta nëpër majat malore të Sharrit përcakton kufirin ndarës, që është pjesë e kufirit ndërshtetëror, në mes të Kosovës dhe Maqedonisë. Përmes luginës së lumit Lepenc (Siriniq) lidhet me Fushën e Kosovës ndërsa përmes Luginës së Lumëbardhit të Prizrenit lidhet me Rrafshin e Dukagjinit.


Pjesa më e madhe e kësaj pasurie i takon sektorit shtetëror e një pjesë më e vogël atij privat. Para luftës banoret e këtij rajoni janë marrë me shumë me blegtori dhe grumbullim të bimëve mjekësore dhe aromatike. Rajonet e Dragashit, Gores dhe Opojës kanë qenë vende tipike blegtorale. Ky rajon ka qenë i njohur edhe në grumbullimin e BMA dhe PFE nga kooperativat të cilat në mënyrë institucionale dhe të kontrolluar kanë bërë grumbullimin.

Në vitet e pas luftës grumbullimi është spontan, i pa organizuar dhe i pa kontrolluar nga institucionet përkatëse shtetërore. Kjo ka shkaktuar dëmtime dhe zvogëlim të fondit me BMA. Disa lloje si *Gentiana lutea* dhe *Gentiana punctata* janë në zhdukje e sipër.

Në kuadër të Maleve të Sharrit hyjnë mjaft hapësira që janë shpallur rezervate natyrore ose zona me vlera të veçanta. Në kuadër të këtyre hapësirave rriten shumë BMA dhe PEFqë kanë rëndësi në zhvillimin socio-ekonomik të këtyre trevave. Vjelja e BMA dhe PFE në këto zona duhet të jetë strikt e kontrolluar në mënyrë që mos të varfërohet biodiversiteti.

Rezervatet strikte natyrore në Malet e Sharrit janë:

- Maja e Arnenit (ish Popovo prase) – që përbëhet nga pyjet e pastra të Rrobullit (*Pinus heldreichii*), që gjendet në Prevallë
- Oshlaku ku dominon *Pinus heldreichii*,
- Pisha e Madhe që shtrihet në shpatijet juglindore të Koxhaballkanit, gjegjësisht në pjesën perëndimore të Parkut Nacional me sipërfaqe prej rreth 44 ha, dhe



- Rusenica që është vendbanim i rrëqebullit ballkanik (*Lynx balcanicus*)


Zonat me vlera të veçanta natyrore janë:

Pashallarë (Ostrovica) – lokalitet i maleve të larta (1600m-2092m)

Koplica është rajon gëlqeror i maleve të larta, me florë dhe faunë mjaft të rrallë

Rajoni i burimit të Lumbardhit të Prizrenit, Luboteni (2496 m) që ka një florë shumë të pasur, Livadhi i mbretit – Liqeni i Jazhincës

BMA dhe PFE në Malet e Sharrit janë ndarë në bazë të territorit që ju takon 6 komunave që janë pjesë e këtyre maleve edhe pse mbledhësit dhe grumbulluesit e mëdhenj të BMA dhe PFE nuk i respektojnë këta kufi administrativ. Dragashi është komuna që ka potencial të BMA dhe PFE, dhe organizim me të mirë.



Tab.6: Sasia e BMA dhe pemë të egra në Malet e Sharrit në bazë komunale

Emri shkencor	Dragash	Suhareka	Prizren	Shterpc	Ferizaj	Kaçanik	Totali
	Kg						
<i>Achillea millefolium</i> (H)	10,500	4,000	10,050	2,500	6,000	4,000	37,050
<i>Aconitum napelus</i> ®	550	0	0	0	0	0	550
<i>Allium ursinum</i> (R, H)	3,090	5,300	550	960	1,100	37,000	48,000
<i>Arctostaphylos uva-ursi</i> (Fol)	6,000	1,140	3,000	4,000	1,000	3,500	18,640
<i>Artemisia vulg.</i> (H)	6,000	6,400	12,000	1,000	8,900	9,700	44,000
<i>Atropa belladonna</i> (Fol)	240	140	240	240	360	220	1,440
<i>Bellis perennis</i> (FI)	4,000	3,000	2,000	2,000	1,500	2,000	14,500
<i>Betula pendula</i> (Fol)	1,525,000	103,000	110,000	100,000	10,000	2,000	1,850,000
<i>Carlina acaulis</i> ®	4,500	2,500	1,000	1,800	500	500	10,800
<i>Centaurium erythraea</i> (H)	5,500	5,500	5,000	3,000	5,000	3,000	27,000
<i>Cichorium intibus</i> ®	11,400	16,000	15,000	4,500	12,500	11,000	70,400
<i>Cornus mas</i> (Fr)	24,960	36,000	65,000	16,000	20,000	20,440	182,400
<i>Corylus avellana</i> (Fr)	6,500	2,300	14,600	3,800	9,800	8,000	45,000
<i>Crataegus monogyna</i> (FI-Fol)	14,750	32,000	43,000	13,000	42,000	30,250	175,000
<i>Digitalis lanata</i> (Fol)	2100	1,900	1,400	800	1,900	1,500	9,600
<i>Epilobium angustifolium</i> (Fol)	12,000	7,000	3,000	5,000	5,000	3,000	35,000
<i>Equisetum arvense</i> (H)	4,000	3,400	3,100	2,000	2,600	500	15,600
<i>Fragaria vesca</i> (Fol)	9,000	7,000	3,000	3,000	6,000	2,814	30,814
<i>Fraxinus ornus</i> (FI)	7,500	9,800	20,000	1,300	14,000	23,000	75,600
<i>Galium verum</i> (H)	24,680	17,320	57,000	32,000	45,000	40,000	216,000
<i>Gentiana asclepiadea</i> ®	5,500	4,000		3,500	1,400	1,440	15,840
<i>Gentiana punctata</i> ®	6,000	5,000	3,900	3,900	3,000	4,800	26,600
<i>Geranium macrorrhizum</i> ®	9,800	34,000	26,000	8,900	13,000	10,700	102,400
<i>Geranium robertianum</i> (H)	9,000	9,100	5,800	9,900	8,800	2,100	44,700

Emri shkencor	Dragash	Suhareka	Prizren	Shterpc	Ferizaj	Kaçanik	Totali
	Kg						
Hypericum alpigenum (H)	4,000	2,500	2,000	2,000	700	0	11,200
Hypericum perforatum (H)	18,400	18,000	15,500	12,600	35,000	10,900	110,400
Juniperus communis (Fr)	145,700	41,300	91,000	98,000	20,000	19,000	415,000
Juniperus nana (Fr)	36,000	20,000	9,100	13,000	16,000	2,500	96,600
Juniperus oxycedrus (F)	1,200	11,000	6,500	4,600	2,300	14,000	39,600
Leucanthemum vulgare	4,400	3,600	2,500	2,500	1,600	1,000	15,600
Malus sylvestris (F)	49,280	23,280	64,000	15,000	23,000	36,000	210,560
Malva sylvestris (Fl)	2,800	2,900	3,400	2,000	4,000	2,900	18,000
Mentha longifolia(Fol)	11,000	18,600	20,100	8,000	6,100	9,000	72,800
Orchis morio (B)	900	650	120	400	350	100	2,520
Origanum vulgare (H)	19,000	17,000	9,000	8,900	15,000	5,920	74,820
Petasites albus ®	9,000	5,000	2,000	5,000	9,000	2,000	32,000
Petasites hybridus ®	20,000	20,000	40,000	160,000	20,000	10,000	270,000
Primal elatior	1,600	300	150	650	150	150	3,000
Primula veris (FL)	2,600	1,300	1,900	1,100	930	1,050	8,880
Prunus spinosa (Fr)	1,100	9,900	15,000	1,300	10,200	10,000	47,500
Pteridium aquilinum ®	80,000	225,000	214,000	80,000	100,100	70,000	769,100
Pyrus sp.	2,000	11,500	14,000	2,800	16,000	9,800	56,100
Robinia pseudoacacia(Fl)	14,700	28,000	21,000	16,000	33,000	34,300	147,000
Rosa sp. (Fr)	62,500	72,000	99,500	47,000	43,500	35,500	360,000
Rubus fruticosus (Fr)	10,000	11,000	13,200	8,000	14,000	11,000	67,200
Rubus idaeus (Fr)	8,000	6,000	4,000	6,000	1,500	2,500	28,000
Salix alba	6,500	25,000	32,000	52,000	19,500	20,000	155,000
Sambucus nigra (Fl)	8,500	7,500	8,500	1,800	8,000	4,000	38,300
Tanacetum vulgare	3,500	4,900	3,800	1,500	8,000	3,500	25,200
Taraxacum officinale (Fol)	17,000	12,000	15,500	13,000	16,100	13,000	86,600
Teucrium chamaedrys (H)	10,000	16,000	18,000	7,000	21,000	15,120	87,120
Teucrium monthanum	8,000	3,000	3,000	3,000	5,000	6,000	28,000
Thymus sp. (H)	21,100	32,000	16,000	13,000	10,500	12,280	104,880
Tilia cordata (Fl)	3,200	10,100	23,000	1,800	8,900	13,000	60,000
Tussilago farfara (Fol.)	8,000	6,400	8,900	5,800	7,600	4,500	41,200
Urtica dioica ®	39,600	46,200	42,000	24,000	25,000	11,000	187,800
Vaccinium myrtillus (Fr)	245,000	82,000	130,000	32,000	28,000	2,000	519,000
Veratrum album.(R)	28,000	28,000	17,000	15,000	12,000	4,000	104,000
Verbascum thapsus (Fl)	14,700	11,800	11,100	900	6,300	2,000	46,800
Veronica officinalis (H)	11,000	11,000	1,000	5,000	7,000	4,100	39,100
Viola tricolor (Fl)	2,400	1,850	1,150	900	1,500	1,400	9,200
Viscum album	5,000	4,000	2,400	4,000	3,500	3,100	22,000
					Totali Kg		7,507,014



Nga tabela shihet së ky regjion është i pasur me BMA dhe PFE. Prej BMA dhe PFE që kanë rëndësi ekonomike dhe që janë të kërkuara në tregun botëror janë: boronica (*Vaccinium myrtillus*), dëllinja (*Juniperus communis*), aguliqja (*Primula veris*), mështekna (*Betulla pendula*), shtogu (*Sambucus nigra*), molla e egër (*Mallus sylvestris*), murrizi (*Crataegus monagina*), thana (*Cornus mas*), lule basami (*Hypericum perforatum*), barpezmi (*Achillea millefolium*), hithra (*Urtica dioica*), listra (*Thymus sp.*), trëndafili i egër (*Rosa canina*) etj.



5.3. Gollaku

Rajoni i Gollakut përfshinë lokalitete të pasura me BMA dhe PFE nga komuna e Prishtinës dhe Kamenicës, mirëpo në këtë rajon janë futur edhe pjesë të Gjilanit dhe Vitisë. Ky rajon në pjesën më të madhe është i përbërë nga pyjet gjetherënës të tipit të dushkut (*Quercion fraineto*). Në pjesët ku lartësia mbidetare është nga 800-1000 m janë në zhvilluar pyjet e Ahut (*Fagetalia*) dhe kullotave të pasura me BMA dhe PFE.

Përveç pyjeve të dushqeve dhe ahut ky rajon është mjaft i pasur edhe me vegjetacion të shkurreve, gjysmë shkurreve dhe vegjetacion barishtor. Në kuadër të kësaj shumëllojshmërie të vegjetacionit rriten shumë BMA dhe PFE.

Rajonet e pasura me BMA të komunës së Vitisë dhe Gjilanit janë të njëjta në aspektin floristik me ato të Gollakut sepse kushtet klimatike dhe ekologjike janë të njëjta.

Novo Brda si lokalitet me i pasur me dëllinjë dhe mështekën dallon nga rajonet tjera të hulumtuara. Ky rajon është i pasur me BMA dhe PFE por lloje me potencial më të lartë janë llojet shkurre si: murrizi, kaça, thana, dëllinja,



lajthia, si dhe drunoret: molla e egër, bagremi, mështekna, shelgu, frashri etj. Prej llojeve barishtore të rëndësishme janë: barë pezmi, lule basami, aguliqja, bresa dhe krasta.

Përbërja gjeologjike

Shikuar nga aspekti gjeologjik pjesa më e madhe e territorit të Gollakut përbëhet nga komplekset e sedimenteve shkëmbore të periudhave të ndryshme gjeologjike. Pra, gjeologjinë e territorit të hulumtuar e përbëjnë: Gëlqerorët, Silikatet dhe Aluviumet (në sipërfaqe të vogla), kurse Serpentiniet janë në fragmente me përjashtim të Malit të Novo Brdes ku serpentiniet zënë pjesën më të madhe.

Përbërja pedologjike


Mbulesa pedologjike e Gollakut duke përfshirë edhe rajonin e Vitisë, Kamenicës dhe Gjilanit është mjaft heterogjene. Ekzistojnë tipe të ndryshme të tokave që kanë mundësuar një diversitet floristik e në kuadër të kësaj edhe mjaft BMA dhe PFE. Në përgjithësi dominojnë:

- Tokë aluvionale – deluvionale teltylorë,
- Rendzinë tipike mbi serpentinë,
- Tokë e kuqe e kafenjësuar mbi formacion të fortë gëlqeror,
- Tokë e kafenjësuar e cekët mbi substrat gëlqeror të fortë,

Tab.7: Sasia e BMA dhe pemë të egra në Gollak në bazë komunale

Emri shkencor	Novo Brdo	Gjilan	Vitia	Kamenica	Prishtine	Total
Pteridium aquilinum	120,000	176,000	300,000	440,000	813,000	1,849,000
Salix alba	560	260,000	50,000	145,000	150,000	605,560
Rosa sp.	68,000	98,000	88,000	240,000	96,000	590,000
Robinia pseudoacacia	32,000	84	109,000	180,000	119,700	440,784
Malus sylvestris	87,000	98,000	35,000	161,280	58,000	439,280
Crataegus monagyna	51,000	150,000	69,000	120,000	48,000	438,000
Betula pendula	360,000	65,000	250	240	500	425,990
Cornus mas	48,000	58,000	15,900	152,000	45,600	319,500
Cichorium intibus	12,000	56,000	19,200	99,200	90,000	276,400
Prunus spicosa	6,400	52,000	12,000	96,800	81,000	248,200
Petasites hybridus	0	110,000	80,000	230	2,500	192,730
Thymus sp.	37,800	65,000	25,200	44,116	18,400	190,516
Tilia cordata	12,000	88,000	54,000	9,000	21,000	184,000
Fraxinus ornus	250	67,200	57,600	980	28,800	154,830
Achillea millefolium	16,000	54,400	18,000	13,650	27,000	129,050
Juniperus communis	90,000	450	20,000	10,770	12,000	133,220
Rubus fruticosus	7,700	27,000	19,200	43,000	3,600	100,500
Tussilago farfara	10,300	16,000	14,000	24,480	35,700	100,480
Galium verum	18,000	25,900	1,300	52,000	1,800	99,000
Mentha longifolia	7,200	30,800	8,400	44,800	1,500	92,700
Sambucus nigra	5,500	15,500	18,240	34,560	8,600	82,400
Hypericum perforatum	11,000	5,600	16,000	35,200	12,600	80,400
Urtica dioica	25,000	1,090	21,600	25,200	6,400	79,290
Origanum vulgare	6,000	11.2	24,500	18,000	9,000	57,511
Teucrium chamaedrys	21,600	17,160	980	1,700	15,000	56,440
Petasites albus	0	16,000	32,000	150	230	48,380
Ononis spicosa	4,800	17,000	4,800	17,600	3,600	47,800
Coryllus avellana	2,000	12,000	7,000	11,000	15,000	47,000
Centaurium erythraea	2,400	4,400	15,200	12,160	9,600	43,760
Hedera helix	1,500	22,000	13,200	790	5,400	42,890
Taraxacum officinale	550	3,700	5,600	5,800	21,600	37,250


Emri shkencor	Novo Brdo	Gjilan	Vitia	Kamenica	Prishtine	Total
Genista tinctoria	11,200	8,800	11,000	1,200	1,800	34,000
Prunella vulgaris	130	17,200	12,000	790	2,916	33,036
Pyrus sp.	3,200	17,000	1,090	6,800	560	28,650
Tanacetum vulgare	1,140	9,720	1,800	6,840	2,160	21,660
Verbascum thapsus	1,300	5,920	5,720	2,700	3,168	18,808
Bellis perennis	750	4,440	6,660	1,080	5,500	18,430
Plantago lanceolata	660	2,200	1,300	1,400	9,500	15,060
Fragaria vesca	1,260	2,400	3,780	1,800	2,520	11,760
Digitalis lanata	1,400	8.4	6,600	780	2,250	11,038
Convollaria majalis	1,590	19.6	5,600	550	2,800	10,560
Cetraria islandica	270	6,000	2,400	760	480	9,910
Linaria vulgaris	570	3,600	990	2,400	1,300	8,860
Primula acaulis	1,840	1,800	1,960	1,800	576	7,976
Carlina acaulis	0	2,500	2,400	340	2,200	7,440
Anemone nemorosa	990	1,980	980	900	2,500	7,350
Primula veris	1,700	1,400	1,080	1,290	260	5,730
Epilobium parviflorum	100	2,800	1,400	130	150	4,580
Polygonatum odoratum	160	2,240	180	720	800	4,100
Sanguisorba minor	770	570	560	870	1,050	3,820
Anthyllis vulneraria	1,800	330	450	790	330	3,700
Scabiosa columbaria	870	570	450	570	150	2,610
Veronica officinalis	2,000	259	140	70	70	2,539
Allium ursinum	0	0	0	2,400	50	2,450
Viola tricolor	230	180	1,200	160	360	2,130
Viola odorata	160	160	150	560	1,000	2,030
Atropa belladonna	170	360	540	570	150	1,790
Gentiana asclepiadea	0	0	130	660	450	1,240
Rubus idaeus	270	0	240	170	150	830
Colchicum automnale	120	140	150	198	180	788
				Totali Kg		7,915,736



Nga tabela 7 shihet së ky regjion është i pasur me BMA dhe PFE. Prej BMA dhe PFE që kanë rëndësi ekonomike dhe që janë të kërkuara në tregun botëror janë: barpezmi (*Achillea millefolium*), molla e egër (*Mallus sylvestris*), murrizi (*Crataegus monagina*), thana (*Cornus mas*), çaj i malit (*Origanum vulgare*), lule basami (*Hypericum perforatum*), listra (*Thymus sp.*), trëndafili i egër (*Rosa canina*), bagremi (*Robinia pseudocacia*), dëllinja (*Juniperus communis*), mështekna (*Betula pendula*) etj.

5.4. Kosova Veriore

Regjioni i Mitrovicës



Kosova veriore përfshin rajone nga komuna e Mitrovicës, Podujevës dhe Vushtrrisë. Në këtë studim nuk janë përfshirë terrene nga komuna e Zubin Potokut dhe Leposaviqit, kështu që mjaftë BMA dhe PFE që rriten në malet e Koritnikut si mali me potencial me të madh me BMA nuk janë evidentuar.

Në territorin e Mitrovicës rajoni me i pasur me BMA dhe pemë

frutor të egra është rajoni i Shalës dhe pjesë të Koritnikut. Kjo zonë është e dominuar kryesisht nga pyjet dushkut, ahut dhe kullosat të cilat janë mjaft të pasura me BMA dhe PEF. Prej BMA me potencial ekonomik dhe që kanë vlera janë: agulicja, murrizi, molla e egër, trëndafili i egër, thana, rigoni i zakonshëm. Kopaoniku është i pasur edhe me Sanzë (*Gentiana lutea*) e cila është në zhdukje si pasojë e vjeljes pa kriter.


Përbërja gjeologjike

Shikuar nga aspekti gjeologjik pjesa më e madhe e territorit të Mitrovicës përbëhet nga komplekset e sedimenteve shkëmbore të periudhave të ndryshme gjeologjike. Kryesisht dominojnë: Gëlqerorët, serpentinet, silikatet dhe Aluviumet (në sipërfaqe të vogla rreth grykave të lumenjve). Shkëmbinjtë serpentini dominojnë kryesisht në Malin Koritnik dhe luginën e lbrit, kurse lokalitetet tjera janë të dominuar nga Shkëmbinjtë gëlqeror dhe silikat.

Përbërja pedologjike

Mbulesa pedologjike e këtij rajoni është mjaft heterogjene. Ekzistojnë tipe të ndryshme të tokave që kanë mundur një diversitet floristik e në kuadër të kësaj edhe mjaft BMA dhe PFE. Në përgjithësi dominojnë:

- Tokë aluvionale – deluvionale teltylorë (Gryka të lumenjve),
- Rendzinë tipike mbi serpentinë (Mali Koritnik, disa pjesë të Shalës)
- Tokë e kuqe e kafenjësuar mbi formacion të fortë gëlqeror (Rajoni i Shalës e më gjerë)
- Tokë e kafenjësuar e cekët mbi substrat gëlqeror të fortë (në mënyrë fragmentare)



Rajoni i Podujevës

Përfshinë pjesë nga Kosova veriore midis Shalës dhe Gollakut.

Kjo zonë është e dominuar kryesisht nga pyjet e dushkut, ahut dhe kullosat të cilat janë mjaft të pasura me BMA dhe PFE. Prej BMA me potencial ekonomik dhe që kanë vlera janë: agulicja, murrizi, molla e egër, trëndafili i egër, shelgu, frashri, thana, lulebasami etj.

Në aspektin **gjeologjik** ky rajon është mjaftë i ngjashëm me atë të Gollakut dhe Shalës, dmth dominojnë shkëmbinjtë gëlqeror dhe silikat.

Në aspektin **pedologjik** ky rajon është mjaft heterogjen, dominojnë tipe të ndryshme të tokave, por në përgjithësi tipet e tokave janë ato të zakonshmet të cekura në rajonin e gollakut dhe Kosovës qendrore.


Tab. 8: Sasia e BMA dhe pemë të egra në Kosovën veriore në bazë komunale

	Mitrovicë	Podujevë	Totali
	Kg		
Achillea millefolium (H)	422	19,200	19,622
Artemisia vulg. (H)	180		180
Atropa belladonna (Fol)	270		270
Bellis perennis (FI)	407	3,300	3,707
Centaureum erythraea(H)	650	9,000	9,650
Cichorium intibus ®	480	63,200	63,680
Convallaria majalis (H)	560	24,500	25,060
Cornus mas (Fr)	1,140	95,000	96,140
Corylus avellana (Fr)	150	12,000	12,150
Crataegus monogyna (FI-Fol)	3,750	120,000	123,750
Digitalis lanata (Fol)	180	9,900	10,080
Epilobium angustifolium(Fol)	9	900	909
Equisetum arvense (H)	115	7,000	7,115
Fragaria vesca (Fol)	315	14,280	14,595
Fraxinus ornus (FI)	840	140,000	140,840
Galium verum (H)	4,400	55,000	59,400
Gentiana asclepiadea ®	160		160
Geranium robertianum (H)	400	7,500	7,900
Hypericum perforatum (H)	320	32,000	32,320
Juniperus communis (Fr)	15,125	24,000	39,125
Juniperus oxycedrus (F)	630		630
Leucanthemum vulgare	52	4,500	4,552
Malus sylvestris (F)	2,688	110,000	112,688
Malva sylvestris (FI)	56	4,800	4,856
Mentha longifolia(Fol)	1,400	11,500	12,900
Ononis spinosa	400	21,000	21,400
Orchis morio (B)	39	252	291
Origanum vulgare (H)	903	52,500	53,403
Petasites hybridus ®	2,100	120,000	122,100
Primula acaulis (FI)	96	2,200	2,296
Primula veris (FL)	3,138	2,320	5,458
Prunus spinosa (Fr)	880	120,000	120,880
Prunus cerasus	33		33
Pteridium aquilinum ®	400	120,000	120,400

Pyrus sp.	680	28,000	28,680
Robinia pseudoacacia(Fl)	1,260	18,200	19,460
Rosa sp. (Fr)	1,600	101,000	102,600
Rubus fruticosus (Fr)	120	9,400	9,520
Rubus idaeus (Fr)	120	1,600	1,720
Salix alba	1,250	137,000	138,250
Sambucus nigra (Fl)	9,384	12,000	21.384
Tanacetum vulgare	216	1,620	1,836
Taraxacum officinale (Fol)	770	11,000	11,770
Teucrium chamaedrys (H)	198	72,600	72,798
Thymus sp. (H)	1,288	68,000	69,288
Tilia cordata (Fl)	9,360	16,000	25,360
Tussilago farfara (Fol.)	520	20,000	20,520
Urtica dioica ®	360	72,000	72,360
Verbascum thapsus (Fl)	247	3,600	3,847
Viola odorata (Fl)	54	730	784
Viola tricolor (Fl)	40	400	440
		Totali Kg	1,849,157

5.5. Kosova Qendrore

Në kuadër të Kosovës qendrore hyjnë vargmalet të cilat ndajnë Rrafshin e Kosovës dhe të Dukagjinit dhe përfshijnë male që hyjnë në kuadër të Komunave: Vushtrri, Skenderaj, Drenas, Klinë, Malishevë dhe Rahovec.



Mali Drenica (1051m) bënë pjesë në Malet qendrore të Kosovës dhe përfshinë një hapësirë nga Gryka e Llapushnik deri në Carralevë. Në kuadër të maleve qendrore të Kosovës hyjnë edhe malet: Kasmaç (976 m), Gradina e Vogël dhe e Madhe (940 m), Buleni (740 m) dhe Mali i Lisit të gjatë (856 m). Këto terrene shtrihen në pjesën qendrore të Kosovës ndërmjet Çyçavicës, Rrafshit të Kosovës (Goleshit), Llapushës, Maleve të Carralevës dhe Anadrinit.

Territori i Malit Drenicë (Llapushnik-Carralevë), Çyçavicë si dhe malet tjera të Kosovës Qendrore, përfshinë terrene në substrate dhe vendbanime të ndryshme natyrore ku pjesa më e madhe mbulohet nga pyjet ndërsa pjesërisht janë të pranishme edhe

kullotat, e më pak livadhet.

Në aspektin e gjeomorfologjik janë mjaft interesante. Lartësia mbidetare sillet prej 650 m deri në 1051 m. Përbërja gjeologjike është e vjetërsive të ndryshme ndërsa petrologjia është mjaft heterogjene. Rol me rëndësi në aspektin gjeomorfologjik kanë grykat të cilat janë të shumta dhe të pasura me BMA dhe PFE.

Përbërja gjeologjike

Shikuar nga aspekti gjeologjik pjesa më e madhe e territorit të Malit Drenicë, Çyçavicë dhe maleve tjera që i takojnë kësaj pjese të Kosovës përbëhen nga komplekset e sedimenteve shkëmbore të periudhës Mezozoike dhe Kenozoike. Pra, gjeologjinë e këtij territori e përbëjnë: *Gëlqerorët*, *Serpentinët*, *Silikatët* dhe *Aluviumet* (në sipërfaqe të vogla).

Përbërja pedologjike

Mbulesa pedologjike e këtij territori është mjaft heterogjene. Pedologjinë e këtyre terreneve e përbëjnë këto tipe të tokave:

- *Deluvium teltylorë,*
- *Tokë aluviale*
- *Rendzinë tipike mbi serpentinë,*
- *Tokë e kuqe e kafenjëzuar mbi formacion të fortë gëlqeror,*
- *Tokë e kafenitë e cekët mbi substrat gëlqeror të fortë,*



Në pjesën më të madhe të territorit të Malit Drenicë tokat nuk janë të favorshme për kultivimin e kulturave bujqësore me përjashtim të sipërfaqeve të vogla aluviale si dhe disa pjesëve të vogla kodrinore andaj këto toka me sukses mund të shërbejnë për kultivimin e BMA dhe PFE.

Malet e Kosovës qendrore janë të dominuar nga pyjet e dushkut, ndërsa zona mbi 800 m e dominuar nga pyjet e ahut. Kullotat janë të tipit kodrinore malore të pasura edhe me shkurre që paraqesin një potencial me BMA dhe PFE.

Prej BMA dhe PFE dominojnë:molla e egër (*Mallus sylvestris*), murrizi (*Crataegus monagina*), thana (*Cornus mas*), çaji i malit (*Origanum vulgare*), lule basami (*Hypericum perforatum*), barpezmi (*Achillea millefolium*), listra (*Thymus sp.*), trëndafili i egër (*Rosa canina*) etj.

Rajoni i Skenderajt, pjesës veriore të Klinës dhe pjesës veriperëndimore të Malishevës

Rajoni i Skenderajt është rajon kodrinor ku dominojnë pyjet e dushkut por në mjaft pjesë ka edhe toka të pa punuara dhe kullosa të pasura me BMA dhe PFE. Kjo ka mundësuar zhvillimin e BMA të tipit shkurror, drunore dhe barishtore. BMA dhe PFE me potencial janë: blini, murrizi, kulumbria, kaça, shelgu, bagremi, dëllinja e zezë, shtogu, frashri etj. prej barishtoreve rëndësi kanë: thundër mushka, bar pezmi, dredhëza e egër, hithra, krasta, menta etj. BMA dhe pemë frutore të këtij rajoni janë paraqitur në tabelën 18.

Rajoni i Dushkajës

Rajoni i Dushkajës përfshinë territore nga komuna e Klinës, Deçanit dhe Pejës. Dominojnë pyjet e dushkut kurse kullota ka pakë, andaj bimët drunore dhe shkurre mbulojnë pjesën më të madhe dhe kanë potencial ekonomik.

Përbërja gjeologjike dhe pedologjike është e njëjtë me pjesë tjera të Kosovës qendrore. BMA dhe PFE që kanë potencial janë: shelgu, bagremi, thana, murrizi, shtogu, trëndafili i egër (kaça), molla e egër etj.

Tab. 9: Sasia e BMA dhe pemë të egra në Kosovën qendrore në bazë regjionale

	Malet e Drenicës	Çyçavica dhe malet tjera të Kosovës qendrore	Rajoni i Skenderajt, Klinës dhe Malishevës	Rajoni i Dushkajës	Total
Emri shkencor	Kg				
Achillea millefolium (H)	16,300	24,000	1,800	2,925	45,025
Arthemisia vulg. (H)	20,000	12,800	6,300	7,100	46,200
Atropa belladonna (Fol)		648	135	180	963
Bellis perennis (FI)	4,400	6,720	1,080	660	12,860
Centaurium erythrea(H)	18,000	12,300	2,800	450	33,550
Cichorium intibus ®	25,000	81,200	4,320	25,200	135,720
Convollaria majalis (H)		9,800	5,600	400	15,800
Cornus mas (Fr)	83,000	136,000	4,560	32,000	255,560
Corylus avellana (Fr)	14,000	11,400	3,000	1,700	30,100
Crataegus monogyna (FI-Fol)	80,000	182,000	24,000	8,200	294,200
Digitalis lanata (Fol)	2,400	3,060	350	300	6,110
Epilobium angustifolium(Fol)		2,400	2,000		4,400
Epilobium parviflorum					
Equisetum arvense (H)	7,440	6,300	1,890	900	16,530
Fragaria vesca (Fol)	5,642	7,900	12,300	3,200	29,042
Fraxinus ornus (FI)	19,200	520,000	19,100	2,160	560,460
Galium verum (H)	20,800	47,600	2,760	12,300	83,460
Gentiana asclepiadea ®		3,400			3,400
Geranium robertianum (H)		800			800
Hypericum perforatum (H)	18,720	14,400	1,044	3,000	37,164
Juniperus communis (Fr)	15,000	42,000	10,800	1,080	68,880
Juniperus oxycedrus (F)	13,200	11,000			24,200
Leucanthemum vulgare	3,120	3,200	955	480	7,755
Malus sylvestris (F)	47,000	82,800	1,800	8,100	139,700
Malva sylvestris (FI)	4,560	6,750	3,690	1,500	16,500
Mentha longifolia(Fol)	10,500	46,000	4,900	250	61,650
Ononis spicosa		64,000	9,100	1,600	74,700
Orchis morio (B)	70	196	343	49	658
Origanum vulgare (H)	27,900	30,000	2,550	2,940	63,390
Petasites hybridus ®		36,000	5,400	1,200	42,600
Primal elatior	480				480
Primula acaulis (FI)		1,800	389	320	2,509
Primula veris (FL)	480	360	180		1,020
Prunus spinosa (Fr)	40,000	200,000	22,400	7,200	269,600
Prunus cerasus		4,000	1,100	2,000	7,100
Pteridium aquilinum ®	80,000	98,000	110,000	1,900	289,900
Pyrus sp.	10,200	19,600	2,378	2,400	34,578

Tab.10: Sasia e BMA dhe pemë të egra në tërë Kosovën në bazë regjionale

Emri shkencor	Alpet Shqiptare	Sharri	Gollaku	Mitrovica-Podujeva	Kosova qendrore	Totali
	Kg					
Achillea millefolium (H)	121,200	37,050	129,050	19,622	45,025	351,947
Aconitum napelus ®	69,300	550	0	0	0	69,850
Allium ursinum (R, H)	0	48,000	2,450	0	0	50,450
Anemone nemorosa (H)	86,140	0	7,350	0	0	93,490
Antennaria dioica (H)	4,200	0	0	0	0	4,200
Anthylis vulneraria	0	0	3,700	0	0	3,700
Arctostaphylos uva-ursi (Fol)	23,300	18,640	0	0	0	41,940
Artemisia vulg. (H)	0	44,000	0	180	46,200	90,380
Asperula odorata (H)	13,800	0	0	0	0	13,800
Atropa belladonna (Fol)	2,979	1,440	1,790	270	963	7,442
Bellis perennis (FI)	37,680	14,500	18,430	3,707	12,860	87,177
Betula pendula (Fol)	100,000	1,850,000	425,990	0	0	2,375,990
Carlina acaulis ®	48,000	10,800	7,440	0	0	66,240
Centaureum erythraea(H)	57,000	27,000	43,760	9,650	33,550	170,960
Cetraria islandica (H)	47,700	0	9,910	0	0	57,610
Cichorium intibus ®	22,400	70,400	276,400	63,680	135,720	568,600
Colchicum autumnale	0	0	788	0	0	788
Convallaria majalis (H)	98,400	0	10,560	25,060	15,800	149,820
Cornus mas (Fr)	288,400	182,400	319,500	96,140	255,560	1,142,000
Corylus avellana (Fr)	43,000	45,000	47,000	12,150	30,100	177,250
Crataegus monogyna (FI-Fol)	205,000	175,000	438,000	123,750	294,200	1,235,950
Crocus sp.(ST)	288	0	0	0	0	288
Digitalis lanata (Fol)	38,900	9,600	11,038	10,080	6,110	75,728
Epilobium angustifolium(Fol)	39,200	35,000	0	909	4,400	79,509
Epilobium parviflorum (Fol)	0	0	4,580	0	0	4,580
Equisetum arvense (H)	0	15,600	0	7,115	16,530	39,245
Fragaria vesca (Fol)	44,688	30,814	11,760	14,595	29,042	130,899
Frangula alnus ®	2,850	0	0	0	0	2,850
Fraxinus ornus (FI)	134,400	75,600	154,830	140,840	560,460	1,066,130
Galium verum (H)	97,220	216,000	99,000	59,400	83,460	555,080
Genista tinctoria (H)	0	0	34,000	0	0	34,000
Gentiana asclepiadea ®	11,674	15,840	1,240	160	3,400	32,314
Gentiana punctata ®	50,400	26,600	0	0	0	77,000
Geranium macrorrhizum®	403,200	102,400	0	0	0	505,600
Geranium robertianum (H)	0	44,700	0	7,900	800	53,400
Hedera helix (Fol)	86,400	0	42,890	0	0	129,290
Hypericum alpigenum (H)	72,300	11,200	0	0	0	83,500
Hypericum perforatum (H)	315,320	110,400	80,400	32,320	37,164	575,604
Juniperus communis (Fr)	275,000	415,000	133,220	39,125	68,880	931,225
Juniperus nana (Fr)	110,000	96,600	0	0	0	206,600
Juniperus oxycedrus (F)	14,400	39,600	0	630	24,200	78,830
Leucanthemum vulgare (F)	0	15,600	0	4,552	7,755	27,907
Linaria vulgaris (H)	0	0	8,860	0	0	8,860

Emri shkencor	Alpet Shqiptare	Sharri	Gollaku	Mitrovica-Podujeva	Kosova qendrore	Totali
Malus sylvestris (F)	140,000	210,560	439,280	112,688	139,700	1,042,228
Malva sylvestris (FI)	0	18,000	0	4,856	16,500	39,356
Mentha longifolia(Fol)	67,000	72,800	92,700	12,900	61,650	307,050
Ononis spinosa ®	0	0	47,800	21,400	74,700	143,900
Orchis morio (B)	5,740	2,520	0	291	658	9,209
Origanum vulgare (H)	90,020	74,820	57,511	53,403	63,390	339,144
Petasites albus ®	200,000	32,000	48,380	0	0	280,380
Petasites hybridus ®	630,000	270,000	192,730	122,100	42,600	1,257,430
Plantago lanceolata (Fol)	0	0	15,060	0	0	15,060
Polygonatum odoratum (H)	0	0	4,100	0	0	4,100
Primal elatior (FI)	0	3,000	0	0	480	3,480
Primula acaulis (FI)	17,700	0	7,976	2,296	2,509	30,481
Primula veris (FL)	20,400	8,880	5,730	5,458	1,020	41,488
Prunella vulgaris (H)	0	0	33,036	0	0	33,036
Prunus spinosa (Fr)	77,000	47,500	248,200	120,880	269,600	763,180
Prunus cerasus (Fr)	0	0	0	33	7,100	7,133
Pteridium aquilinum ®	1,078,000	769,100	1,849,000	120,400	289,900	4,106,400
Pyrus sp. (Fr)	40,000	56,100	28,650	28,680	34,578	188,008
Robinia pseudoacacia(FI)	123,800	147,000	440,784	19,460	219,000	950,044
Rosa sp. (Fr)	472,000	360,000	590,000	102,600	350,200	1,874,800
Rubus fruticosus (Fr)	45,600	67,200	100,500	9,520	44,600	267,420
Rubus idaeus (Fr)	34,800	28,000	830	1,720	1,890	67,240
Salix alba (Cor)	70,000	155,000	605,560	138,250	449,800	1,418,610
Sambucus nigra (FI)	23,040	38,300	82,400	21,384	20,240	185,364
Sanguisorba minor (H)	0	0	3,820	0	0	3,820
Scabiosa columbaria (H)	0	0	2,610	0	0	2,610
Tanacetum vulgare	21,600	25,200	21,660	1,836	35,982	106,278
Taraxacum officinale (Fol)	91,760	86,600	37,250	11,770	36,500	263,880
Teucrium chamaedrys (H)	67,280	87,120	56,440	72,798	94,940	378,578
Teucrium monthanum (H)	0	28,000	0	0	500	28,500
Thymus sp. (H)	237,292	104,880	190,516	69,288	57,000	658,976
Tilia cordata (FI)	75,000	60,000	184,000	25,360	69,100	413,460
Tussilago farfara (Fol.)	120,700	41,200	100,480	20,520	47,280	330,180
Urtica dioica ®	208,800	187,800	79,290	72,360	36,480	584,730
Vaccinium myrtillus (Fr)	303,000	519,000	0	0	0	822,000
Veratrum album.(R)	132,800	104,000	0	0	0	236,800
Verbascum thapsus (FI)	16,650	46,800	18,808	3,847	7,577	93,682
Veronica officinalis (H)	34,500	39,100	2,539	0	7,760	83,899
Viola odorata (FI)	1,010	0	2,030	784	1,020	4,844
Viola tricolor (FI)	3,136	9,200	2,130	440	640	15,546
Viscum album	0	22,000	0	0	0	22,000
Totali	7,413,367	7,507,014	7,915,736	1,840,157	4,197,073	28,882,347

7. Aktoret e sektorit

Perceptimi i pronarëve të kompanisë mbi situatën e tregut

Në bazë të bisedave të zhvilluara gjatë tri viteve (2006-2009) me pronaret e kompanive që merren me tregtimin e BMA dhe PFE ekziston një avancim i bizneseve të tyre dhe një plasim me i madh i këtyre produkteve në tregun e jashtëm.

Ndihmës të madhe në këtë drejtim kanë dhënë sidomos vizitat e pronarëve të këtyre kompanive në vende të Bashkimit Evropian organizuar dhe financuar nga Intercooperation dhe GTZ. Këto vizita kanë afruar njohuri të avancuara në aspektin e menagjimit dhe tregtimin e BMA, si dhe përmbushjen e standardeve që kërkojnë ofertuesit nga Bashkimi Evropian. Këto vizita kanë ndihmuar shumë edhe kompanitë që janë në fazën e certifikimit të tyre.

Mungesa e informacioneve të nevojshme lidhur me tregun është problem i theksuar dhe pengesë kryesore që frenon marketingun e kompanive grumbulluese dhe eksportuese.

Mungesa e kontratave afatgjata midis eksportuesve dhe kompanive të jashtme importuese është një nga pengesat kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm të këtij biznesi. Kjo është pasojë e politikave të kompanive të ndryshme të jashtme që dëshirojnë që mallin e importuar ta blejnë me çmime sa me të ulëta.

Ky problem shpesh i venë në pozitë të vështirë kompanitë vendore të cilat ndonjëherë nuk arrijnë që ta tregtojnë mallin. Malli i grumbulluar në depo për kohë të gjatë ju shkakton humbje kompanive grumbulluese dhe eksportuese. Kjo ndikon negativisht edhe të grumbulluesit e vegjël të cilët shpesh kushtëzohen që pagesa për mallin e dorëzuar të bëhet pas shitjes nga ana e Kompanive të mëdha.

Mungesa e kontratave afatgjata midis eksportuesve dhe kompanive të jashtme importuese ka për pasojë:

Pa mundësin e planifikimit për të grumbulluar sasi të caktuara të BMA dhe PFE nga ana e kompanive grumbulluese.

Mos informim me kohë të grumbulluesve të vegjël dhe vjelësve lidhur me llojet dhe sasinë që duhet grumbulluar.

Mungesa e një çmimi stabil dhe të garantuar nga kompanitë e mëdha për secilin lloj të BMA.

Megjithatë grumbullimin e BMA dhe PFE duhet parë në tri aspekte:

- Si burim të ardhurash për popullsinë fshatare
- Ngritja e kapaciteteve të kompanive grumbulluese dhe eksportuese
- Rritja e eksportit në nivel të Kosovës

Kuotat optimale për vjeljet e BMA dhe PFE

BMA dhe PFE mblihen kryesisht në pyje dhe kullota në sektorin shtetëror. Mbledhja e këtyre produkteve nuk bëhet në bazë të rregulloreve të aprovuara nga ministria përkatëse. Grumbulluesit e mesëm dhe të mëdhenj shpesh për shkaqe konkurrence nuk përfillin rregullat e grumbullimit dhe për pasojë shumë lloje rrezikohen të zhduken ose të zvogëlohet sfondi i tyre dhe pamundësohet aftësia e tyre riprodhuese.

Mbarështimit të BMA dhe PFE i mungon mbështetja me të dhënat nga inventarizimet dhe kërkimet shkencore.

Vjelësit nuk posedojnë një listë me lloje të rrezikuara dhe për pasoj ata mbledhin krejt çka munden dhe është në dobi të interesit të tyre ekonomik. Nga ana tjetër Ministria e Bujqësisë dhe pylltarisë nuk arrin të ndëshkoi individët ose kompanitë që nuk respektojnë kriteret e vjeljes të parapara me ligj.

Një individ ose grumbullues në fillim të marrjes me këtë aktivitet duhet të regjistrohet si një biznes, duke formuar kështu një person juridik. Pastaj ai duhet të siguroi një licencë që e bënë atë të specializuar për t'u marrë me BMA dhe pemë frutore të egra.

Leja për të ushtruar këtë veprimtari duhet të përsëritet çdo vit nga ana e drejtorive regjionale të pylltarisë. Kompanitë grumbulluese duhet të parashtrojnë kërkesë për sasi që duan të grumbullojnë dhe për këtë të paguajnë tarifa konform ligjit. Sasitë që duhet mbledhur nga kompanitë duhet caktuar në marrëveshje me Ministrin e Bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural. Kjo sasi duhet të caktohet në bazë të potencialeve që kanë BMA pa rrezikuar asnjëherë potencialin e tyre riprodhues. Vjeljen e qëndrueshme duhet ta kontrolloi shteti për mes kompanive të certifikuara për grumbullimin e BMA dhe pemëve të egra. Kompanitë grumbulluese duhet të posedojnë dokumentacionin përkatës për secilin lloj, duhet të posedojnë dokumentacion që siguron informata lidhur me lokalitetin dhe sasinë ku është grumbulluar lloji i caktuar.

Vjelësit e BMA dhe PFE

Vjelësit janë njerëzit që vjelin BMA dhe PFE dhe pjesa dërmuese e tyre ju përkasin viseve rurale ku bëhet vjelja. Numri i tyre në Kosovë, edhe pse nuk ekzistojnë shifra të sakta është mjaft i madh.

Ekzistojnë dy kategori të vjelësve të BMA dhe PFE:

Vjelësit që materialin e grumbulluar e dorëzojnë në Kompanitë e mesme dhe të mëdha dhe vjelësit që vetë e shesin këtë mall ose e përdorin për nevoja personale.

Shqetësimet e mbledhësve të bimëve

- Çmimet e ulëta
- Çmimet jo stabile
- Zbritja e çmimeve për disa artikuj
- Largësia nga qendrat e grumbullimit
- Mungesa e infrastrukturës për transport ose përpunim (tharje)
- Vonesa e pagesave
- Mungesa e një tregu të garantuar
- Mos kontrolli i tregjeve
- Kërkesat vetëm për disa BMA
- Vjelja pa kriter e personave të pa ndërgjegjshëm
- Mungesa e një menagjimi dhe kontrolli nga ana e shtetit

Grumbulluesit e BMA dhe PFE

Ekzistojnë pika grumbullimi në të gjitha zonat e pasura me BMA, PFE e sidomos me kërputha. Këta persona kanë njohuri të mira lidhur me ecurinë e grumbullimit, tharjes dhe eksportimit deri të kompanitë eksportuese. Grumbulluesit i shesin prodhimet sa ma shpejtë që munden me disa përjashtime kur çmimet janë shumë të ulëta.

Shqetësimet kryesore të grumbulluesve janë:

- Mungesa e parave kesh për të paguar mallin e marrë nga vjelësit

- Shkalla e larë e interesit të kredive bankare
- Mos arritja e shitjes me kohë e mallit
- Pa mundësia e grumbullimit të sasive të mëdha të BMA si pasojë e mungesës financiare dhe luhatjes së çmimeve në tregje
- Mungesa e informacioneve lidhur me çmimet dhe ofertat
- Mungesa e shkëmbimit të informacioneve midis grumbulluesve vendor

8. Vlera ekonomike tregu dhe organizimi i grumbullimit dhe shitjes

Përshkrim i përgjithshëm

Për shumë banor të zonave rurale që shtrihen afër rajoneve të pasura me BMA dhe pemë frutor marrja me këtë veprimtari paraqet një burim të ardhurash shtesë të rëndësishëm. Për disa familje këto të ardhura paraqesin burimin e vetëm të ekzistencës. Përparësi në zhvillimin e këtij aktiviteti kanë familjet që kanë numër të madh të fëmijëve dhe që gjenden afër qendrave të grumbullimit me ç'rast materialin e mbledhur nuk kanë nevojë që ta thajnë.

Përfitime nga shfrytëzimi i qëndrueshëm i BMA dhe PFE si resurse natyrore

Me këtë objektiv arrihet kontrolli i shfrytëzimit të kullotave dhe livadheve për blegtori dhe për vjeljen e BMA dhe PFE, në mënyrë ekologjike dhe të organizuar sipas etapave kohore sezonale dhe sipërfaqeve të destinuara, për nevoja të përfitimeve ekonomike. Kjo për më tepër rezulton në mbrojtjen e mjedisve të pasura në këtë aspekt, shfrytëzimin e tyre, menagjimin e mirë dhe arritja e përfitimeve ekonomike për të gjithë faktorët e involvuar në këtë proces.

Ky objektiv arrihet me këto masa/veprime/projekte /aktivitete:

- Hartimi i udhëzimit administrativ/rregullores për shfrytëzimin e sipërfaqeve të caktuara për kullosa, mbledhjen e BMA dhe PFE
- Caktimi i zonave, sipërfaqeve dhe afateve kohore për shfrytëzim të mundshëm për kullotje të bagëtisë dhe mbledhje të BMA dhe PFE.
- Organizimi dhe menaxhimi i produkteve pyjore që vjelën nga ana e kompanive të certifikuara.
- Kontrolli shtetëror i këtyre kompanive në aspektin e zbatimit të ligjit dhe rregulloreve lidhur me shfrytëzimin e qëndrueshëm të BMA dhe PFE si resurse kombëtare.

Të ardhurat e gjeneruara nga njerëzit e angazhuar në mbledhjen, tharjen, shitjen brenda Kosovës dhe eksportimi jashtë i BMA dhe PFE nuk dihen sakt .

Pothuajse të gjitha BMA dhe PFE mbledhen në natyrë si të egra dhe mbledhës potencial janë edhe barinjtë të cilët në të njëjtën kohë ruajnë bagëtinë dhe mbledhin BMA në të njëjtin lokalitet. Kjo bien ndesh me rregullat e përcaktuara nga kompanitë që bëjnë licencimin. Dihet së në vende ku kullotja është intensive nuk lejohet mbledhja e BMA si pasojë e ndotjes organike nga bagëtia. Shumë herë mbledhësit materialin e mbledhur e terin në stallat e tyre ose në bjeshkë afër staneve pa pasur kushte minimale. Ky element duhet të sanohet, përndryshe kompanitë e huaja do heqin dorë nga produktet që ofrojnë kompanitë eksportues kosovare si pasojë e mos përmbushjes së standardeve të kërkuara.

Për të fituar me shumë individët e caktuar shpesh mbledhin BMA pa plotësuar as një kriter. Kjo dukuri për një periudhë të shkurtër do sjellë pasoja negative në aspektin e diversitetit floristik dhe në punën e vetë grumbulluesve të vegjël dhe kompanive të mëdha.

Përveç këtij fenomeni mbledhja jo me kohë dhe konformë rregullave të përcaktuara do të ulë cilësinë që do këtë për pasojë humbjen e tregut të jashtëm.

Vetëdijesimi dhe informimi për BMA dhe PFE

Është më se e domosdoshme të bëhet vetëdijesimi dhe informimi në kohë e gjithëpërfshirës, i popullatës dhe institucioneve, mbi rolin, rëndësinë dhe përfitimet që mund të vijnë nga bimët si resurse natyrore. Vazhdimësia e këtij procesi, është me rëndësi për trendët e zhvillimeve si në arenën kombëtare, rajonale ashtu edhe atë ndërkombëtare, veçanërisht për popullatën që bashkëjeton me BMA dhe pemët frutor. Procesi i informimit duhet të bëhet në mënyrë të vazhdueshme përmes krijimit, ngritjes dhe funksionalizimit të sistemit të informimit. Për realizimin e këtij procesi duhet të angazhohen struktura të caktuara shtetërore kompetente dhe kompanitë që merren me grumbullimin dhe eksportin e këtyre produkteve.

Aktivitetet për përmbushjen e objektivit për vetëdijesim dhe informim për BMA dhe PFE (pemët frutore të egra):

- Përgatitja e stafit të pylltarisë më njohuri bazë për BMA dhe PFE.
- Edukimi i vjelësve të vegjël, grumbulluesve dhe kompanive eksportuese lidhur me vjeljen e qëndrueshme dhe menagjimin e këtyre resurseve.
- Hartimi i ligjeve që parashohin masa të rrepta në mbrojtjen e llojeve të rrezikuara nga zhdukja.
- Botimi i broshurave, fletëpalosjeve si dhe financimi nga kompanitë dhe shteti i reklamave me karakter edukativ përmes mediave të shkruara dhe elektronike.
- Organizimi i ekskursioneve edukative dhe arsimore në zona të pasura me BMA dhe PFE.
- Sensibilizim të banorëve të vendbanimeve përreth zonave të pasura me BMA dhe PFE për rëndësinë që ka ruajtja e mjedisit, pyjeve dhe kullosave si biotope që mundësojnë një diversitet floristik dhe zhvillim të qëndrueshëm.
- Hartimi i Udhëzimit Administrativ – Rregullores që saktëson të drejtat dhe obligimet e vjelësve, grumbulluesve, kompanive përpunuese dhe eksportuese. mbi lejimin dhe ndalimin e aktiviteteve si dhe gjobat ndaj shkelësve të rregullave të parapara lidhur me këtë veprimtari, ndotësve të këtyre resurseve (personat fizik dhe juridik) etj.

Mbrojtja e pyjeve nga faktorët natyror dhe njerëzor

(prerjet, sëmundjet, zjarret, ortiqet dhe erozionet)

Në bazë të hulumtimeve të bëra të gjendjes ekzistuese të pyjeve të sektorit publik si resurse kryesore me BMA dhe PFE, mund të konstatojmë se në disa rajone janë të dëmtuara dhe degraduara. Degradimi i pyjeve ka si pasojë zvogëlimin e diversitetit floristik e në këtë kontest edhe të BMA dhe ardhjen në shprehjeve të neofitëve dhe barojave të këqija. Faktor dominues në varfërimin e diversitetit floristik e në këtë kontekst edhe BMA dhe pemëve frutor të egra janë prerjet pa kriter të pyjeve, zjarrvënjet që shpesh shkaktojnë ndryshim të florës ekzistuese dhe paraqitjen e erozionit në këto hapësira si faktori me negativ në varfërimin e pyjeve dhe kullotave në aspektin e florës.

Ortiqet janë me të rralla dhe zakonisht dame të mëdha shkaktojnë në vendet ku është i degraduar pylli në zonën e lartë malore.

Aktivitetet për arritjen e objektivit janë:

- Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit për mbrojtjen e pyjeve në mes të Pushtetit qendror, atij lokal dhe Gjykatave komunale.
- Ndalimin e menjëhershëm të prerjes ilegale të pyjeve si dhe rritjen e tarifave ndëshkimore për prerësit ilegal të pyjeve.
- Rritja e numrit të rojeve si dhe përmirësimi i kushteve dhe pajisjeve të nevojshme për vërtetim, telekomunikim, mbrojtje dhe lëvizje;
- Krijimi i infrastrukturës me qëllim të mbrojtjes së pyjeve nga zjarri si faktor që shkreton sipërfaqe shumë të mëdha me pyje dhe BMA.
- Prerja e kontrolluar nga pylltarët, dhe ripyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura.
- Identifikim i vendeve për pyllëzime dhe ripyllëzime

9. Politikat zhvillimore të sektorit

Prerjet pa kriter të pyjeve, mbikullotja, vjeljet jo të kontrolluara dhe zjarr vëniet janë faktorët kryesor që direkt ndikojnë në biodiversitetin e një vendi dhe në pakësimin e BMA dhe PFE. Si pasojë e një menagjimi jo të mirë të pyjeve dhe kullotave si resurse natyrore në shumë vende vërehen pasojat ekologjike si: degradimi i tokës, shfaqja e erozionit zvogëlimin e biodiversitetit dhe paraqitjen e barojave të këqija në biotope të pasura me BMA.

Në bazë të intervistave të bëra nga drejtorit e pylltarive të regjioneve dhe ruajtësit e pyllit shkaktari kryesor në mos arritjen e ruajtjes së pyjeve është mos funksionimi dhe korrupsioni që ekziston në gjykatat komunale. Prerësit ilegal të pyjeve dhe tregtimi i masës drunore nuk ndëshkohet nga ana e gjykatave komunale. Kjo ka bërë që këta individ të vazhdojnë këtë veprimtari pa problem duke shkatërruar sipërfaqe të tera.

Shpresa e vetme për të ndikuar në ruajtjen e këtyre resurseve që kanë rëndësi kombëtare është decentralizimi i qeverisjes së pyjeve dhe kalimi i tyre në pronësi komunale.

Certifikimi i Kompanive që merren me BMA, pemë frutorë të egra dhe kërpudha

Certifikimi i Kompanive që merren me BMA, PFE dhe kërpudha ka rëndësi të madhe në radhë të parë për vetë kompanitë. Edhe në qoftë se nuk do të ketë ngritje të çmimeve të këtyre produkteve; do të krijohet një treg me i qëndrueshëm dhe me më shumë ofertues serioz nga Evropa.

Procesi i certifikimit ka filluar në Kosovë dhe tani veç janë disa Kompani të certifikuar për disa produkte natyrore ndërsa të tjerat janë në procedurë të certifikimit.

Kompanitë e certifikuar do të luajnë rol të madh në procesin e vjeljes, grumbullimit dhe eksportit të BMA, PFE dhe kërpudhave. Kontributi i tyre kryesor do të jetë në menagjimin dhe vjeljen e qëndrueshme të këtyre produkteve. Kontrolli me i lehtë i këtyre kompanive nga ana e shtetit dhe planifikimi me i mirë lidhur me ruajtjen nga zhdukja e llojeve bimore të rrezikuara.

Mbrojtja dhe ruajtja e biodiversitetit në rajonet e pasura me BMA dhe PFE

Mbrojtja e biodiversitetit, e sidomos e bimëve të rrezikuara, është me interes të ruajtjes së trashëgimisë natyrore globale në përgjithësi dhe asaj kombëtare në veçanti. Për tu arritur

ky objektiv duhet punë profesionale-shkencore dhe institucionale. Aktivitete tjera që duhet ndërmarr janë edhe:

- Hulumtimi, evidentimi dhe inventarizimi i BMA dhe PFE.
- Publikimi atlasit botanik me BMA dhe PFE.
- Përpilimi hartës me areale të BMA dhe PFE.

Ndarja e kompetencave midis Ministrisë së bujqësisë pylltarisë dhe zhvillimit rural, Ministrisë së mbrojtjes së ambientit dhe pushtetit lokal.

Identifikimi i habitateve të rrezikuara

Mbrojtje, monitorim dhe shfrytëzim racional të resurseve të natyrës që arrihet përmes një menaxhimi efikas dhe ndarje të kompetencave për përkujdesje më të madhe, dhe monitorim të habitateve potenciale me BMA dhe PFE.

10. Njohja e bimëve kusht për sukses

Edhe bimët e dëmshme mund të jenë të vlefshme!

Është me rëndësi të kuptohet se shumë bimë të dëmshme (baroja të këqija) për kulturat bujqësore mund të përdorën në farmaceutikë sepse përmbajnë materie aktive (droga) të rëndësishme psh trasta e bariut (*Capsella bursa pastoris*, speciet e gjinisë *Digitalis* etj.).

Si duhet dhe si nuk duhet të shfrytëzohen bimët mjekësore?

Një gjë është e sigurt! Gjatë kohës së pushtimeve të vendeve të ndryshme, pushtuesit shfrytëzojnë në maksimum dha pa kurrfarë kriteri pasurit e një vendi. Në kuadër të këtyre pasurive hyjnë edhe bimët mjekësore dhe aromatike. Në vendin tonë shfrytëzimi i bimëve mjekësore në këto njëqind vitet e fundit është bërë jashtë çdo norme. Si pasojë e kësaj disa lloje bimore janë zhdukur ose janë afër zhdukjes dhe ato sot rriten në vende ku kanë qenë të mbrojtura në mënyrë natyrale, në areale të vogla. Këtë e argumenton edhe fakti se lloji bimor *Gentiana lutea* e cila në Kosovë ka pasur një areal të gjerë të shtrirjes, sot është shumë e rrallë dhe gati në zhdukje si pasojë e mbledhjes pa kriter.

Njohja e bimëve mjekësore është mjaft e ndërlikuar!

Është më rëndësi të madhe njohja e mirë e bimëve shëruese dhe helmuese. Njohja e mirë e shtrirjes gjeografike të një lloji bimor, pamja e bimës, përbërja e sajë kimike, dukja e drogave (pjesët e thara të bimës), përdorimi i tyre në aspektin shkencor dhe popullor ka rëndësi të madhe. Mjekësia popullore duhet të kontrollohet në mënyrë që njerëzit e pa ndërgjegjshëm, dhe të pa përgatitur në këtë aspekt (sharlatanët) të mos manipulojnë me njerëzit e sidomos kur janë në pyetje fëmijët.

Helmimi me bimë mjekësore me veprim të fortë!

Përdorimi i farave të daturës (*Datura stramonium*) ose të ricinit (*Ricinus communis*) si helme është i njohur prej kohërave të lashta. Përdorimi i organeve bimore në mjekësin popullore pa njohuri të mira mund të ketë efekte anësore të dëmshme. Çdo person që merret me bimët mjekësore duhet të njoh mirë edhe bimët helmuese. Ekzistojnë bimë helmuese që kanë materie helmuese të koncentruara të cilat edhe në sasi të vogla mund të shkaktojnë komplikime të mëdha madje edhe vdekjen. Psh. Prekja vetëm me gjuhë e rrënjëve të bimës *Aconitum toxicum* mund të shkaktoi probleme në sistemin respirator.

11. Kullotja/mbikullotja

Kullotja intensive dhe pa plan ka për pasojë zvogëlimin e llojeve të BMA dhe PFE e në disa raste edhe zhdukjen e tyre. Mbikullotja shkakton zvogëlimin dhe dobësimin e sistemit rrënjor si pasojë bimët nuk mund të përfundojnë përdhën vegetative. Ky fenomen ju pa mundëson bimëve barishtore formimin e frutit dhe farës që ka si pasojë pa mundësin e riprodhimit për mes farës. Mbikullotja shkakton edhe ngjeshjen e tokës që ka si pasojë uljen e pjellorisë së sajë deri në 30%.

Kullotat, blegtoret dhe grumbulluesit e BMA dhe PFE

Interesat e blegtorëve janë në kundërshtim me ato të grumbulluesve të BMA. Blegtoret janë të interesuar që në kullota të dominojnë bimët foragjere që paraqesin ushqim kualitativ për bagëtinë dhe që ka për pasojë rritjen e sasisë së qumështit dhe mishit, përdërisa grumbulluesit e BMA janë të interesuar që të vjelin sa me shumë BMA.

Në këto pozita kur nuk ka një menagjim të mirë të kullotave; grumbulluesit janë të detyruar që të gjejnë ishuj të vegjël të pasura me BMA dhe ato t'i vjelin pa kriter dhe me metoda që për ta janë me të lehta.

12. BMA dhe PFE tjera në Kosovë

Në kuadër të BMA dhe PFE të përhapura në florën e Kosovës hyjnë edhe shumë lloje tjera të cilat janë përfshirë në tabelën 11.

Vërejtje:

Në kuadër të kësaj liste llojet *Pinus mugo* (dredhaku), dhe *Castanea sativa* (gështenja) që nuk janë përfshirë në tabelat e me sipërme janë lloje që kanë potencial të lartë. E para është e përhapur kryesisht në Alpet Shqiptare dhe Malet e Sharrit në zonën subalpine dhe alpine kurse gështenja ka një shtrirje mjaft të gjerë duke filluar nga Morina dhe vazhdon deri të Gryka e Rugovës.

